



Funded by
the European Union

Dokument Pozicioni: Plani Kombëtar i Kosovës për Energjinë dhe Klimën (PKEK)

Maj 2022



Përmbledhje Ekzekutive

Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër në nëntor 2020, liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor u zotuan për dekarbonizim deri në vitin 2050, që do të thotë ndalimin e përdorimit të të gjitha lëndëve djegëse fosile – naftë, gaz dhe thëngjill. Një nga piketat për arritjen e këtij objekti është adoptimi i caqeve për vitin 2030 për eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.²

Hartimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) është një pjesë thelbësore e këtij procesi i cili do të përcaktojë veprimet e Kosovës nga tani deri në vitin 2030. PKEK-të duhet të mbulojnë pesë shtyllat e politikës e BE-së për Unionin e Energjisë:³

- Siguria e energjisë, solidariteti dhe besimi;
- Tregu plotësisht i integruar i brendshëm i energjisë;
- Eficienca e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës;
- Dekarbonizimi i ekonomisë; dhe
- Kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria

Secila prej tyre paraqet një sfidë për Kosovën, sektori i energjisë i së cilës është në udhëkryq dhe kërkon vendime gjithnjë e më urgjente se si të ecet përpara.

Ky dokument i pozicionit synon të ofrojë rekomandime për PKEK-në e Kosovës që aktualisht është duke u përgatitur, nga pikëpamja e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përfshirjes publike. Ai përqendrohet kryesisht në shtyllat e PKEK-së për sigurinë e energjisë, eficiencën e energjisë dhe dekarbonizimin, duke synuar të ndihmojë Kosovën të mësojë nga përvojat e të tjerëve në planifikimin e zgjidhjeve të dëshmuara të pranueshme mjedisore dhe shoqërore.

Dokumenti ynë ofron 32 rekomandime të cilat përqendrohen kryesisht në lëvizjen e Kosovës drejt një ekonomie me eficiencë të energjisë dhe me burime të ripërtëritshme në shkallë 100 për qind, të bazuar në integrimin e ngushtë të tregut, gjenerimin fleksibil të energjisë elektrike dhe elektrifikimin e sektorëve të transportit dhe ngrohjes.

Një nga sfidat do të jetë shmangia e shpërqendrimit në politika të cilat më vonë mund të rezultojnë të jenë kundërproduktive, si gazi fosil, hidrogjeni me bazë fosile, biomasa pyjore, incinerimi i mbeturinave ose biokarburantet. E ardhmja energjetike e Kosovës qëndron në tregun energjetik të BE-së, por ajo duhet të gjejë rrugën e vet për ta vënë tranzicionin energjetik në funksion të së mirës së vendit.

Për këtë qëllim është thelbësore përfshirja e publikut në debatin e politikave të energjisë, për të mbledhur ide dhe për të adresuar shqetësimet. Sektori i energjisë ka ndikuar në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, si dhe në portofolat e tyre, për dekada të tëra. Por më shumë se kurrë, tani ekzistojnë mundësi dhe ka nevojë që publiku të marrë pjesë aktive, qoftë si prodhues të energjisë elektrike për vetë-konsum (prosumatorë), duke izoluar shtëpitë e tyre ose duke instaluar pompa termike. Kosova tashmë ka filluar të kultivojë potencialin e prosumatorëve dhe duhet t'i zhvillojë të gjitha këto mënyra të pjesëmarrjes së publikut shumë më tej.

¹ [Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, 10 nëntor 2020.](#)

² Për të arritur caqet e tyre të mëparshme për vitin 2020, secili vend duhet të përgatiste Plane Veprimi për Energjinë e Ripërtëritshme dhe Plane Veprimi për Eficiencën e Energjisë në nivelin kombëtar. Ata ende mund ta bëjnë këtë nëse dëshirojnë, por nuk janë më të detyruar.

³ [Policy Guidelines by the Energy Community Secretariat on the development of National Energy and Climate Plans under Recommendation 2018/01/MC-EnC PG.03/2018, Qershor 2018](#)

Hyrje

Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër në nëntor 2020,⁴ liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor u zotuan për dekarbonizim deri në vitin 2050, që do të thotë ndalim i përdorimit të të gjitha lëndëve djegëse fosile – naftë, gaz dhe thëngjill. Një nga piketat për arritjen e këtij objekti është adoptimi i caqeve për vitin 2030 për eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.⁵

Për të planifikuar për këto në një mënyrë të integruar, u prezantua koncepti i Planeve Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (PKEK) nga Rregullorja e Bashkimit Evropian për Qeverisjen⁶ si pjesë e pakos Energji e Pastër për të Gjithë Evropianët⁷ e miratuar gjatë 2018 dhe 2019.

Në nëntor 2018, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë miratoi një Rekomandim⁸ që thotë se Palët Kontraktuese, duke përfshirë Kosovën, do të duhej gjithashtu të përgatisin PKEK-të sa më shpejt të jetë e mundur. Mirëpo, ka pasur një vonesë të madhe në përcaktimin e caqeve për vitin 2030 në Komunitetin e Energjisë,⁹ gjë që vonoi gjithashtu adoptimin formal të Rregullores së Qeverisjes nga Komuniteti i Energjisë.

Caqet nuk janë vendosur ende, por një draft i parë i caqeve të propozuara nga konsulentët e angazhuar nga Komisioni Evropian u publikua në fillim të prillit 2022¹⁰ (shih seksionin Dekarbonizimi) dhe do të konsultohet me vendet në muajt e ardhshëm.

Në nëntor 2021, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë miratoi gjithashtu një version të përshtatur të Rregullores së Qeverisjes, duke vendosur një afat të detyrueshëm deri në qershor 2024 për dorëzimin e PKEK-ve përfundimtare.¹¹ Projektplanet duhet të dorëzohen deri në qershor 2023.¹² Nga njëra anë, nevojitet kohë për transpozimin dhe përfshirjen e caqeve të ardhshme në PKEK. Por në realitet, është jashtëzakonisht vonë, ngase edhe qeveritë edhe investitorët duhet urgjentisht ta kenë të qartë drejtimin që do të marrë sektori i energjisë në vitet e ardhshme dhe shumë prej vendeve, përfshirë Kosovën, kanë strategji dhe dokumente të tjera të politikave të energjisë që janë tmerrësisht të vjetruara.

Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë dorëzuar draftet e PKEK-ve të tyre në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë,¹³ por në vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë – përfshirë Kosovën – nga mesi i prillit 2022 dokumentet nuk ishin ende të disponueshme për publikun. Kosova ka një grup punues për përgatitjen e PKEK-së dhe ka filluar hartimi,¹⁴ por ende nuk janë mbajtur konsultime publike. Një Strategji e re e Energjisë për të zëvendësuar atë të fundit nga viti 2017¹⁵ është duke u përgatitur gjithashtu, së këndejmi supozohet që këto janë duke u koordinuar me njëra-tjetrën.

⁴Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, 10 nëntor 2020.

⁵Për të arritur caqet e tyre të mëparshme për vitin 2020, secili vend duhej të përgatiste Plane Veprimi për Energjinë e Ripërtëritshme dhe Plane Veprimi për Eficiencën e Energjisë në nivelin kombëtar. Ata ende mund ta bëjnë këtë nëse dëshirojnë, por nuk janë më të detyruar.

⁶Regulation (EU) 2018/1999 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 on the Governance of the Energy Union and Climate Action.

⁷Komisioni Evropian, Clean Energy for all Europeans Package, qasur më 4 prill 2022.

⁸Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, Recommendation 2018/01/EnC-MC, Nëntor 2018.

⁹Kjo ndodhi për shkak se studimi i parë mbi caqet e mundshme që u porosit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nuk u çmua mjaftueshëm i fortë nga Komisioni Evropian, i cili më pas porosit një studim të dytë.

¹⁰E3 Modelling, Energy Community - project update, 7 prill 2022.

¹¹Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, Decision 2021/14/MC-EnC: amending Article 20 and Annex I to the Treaty establishing the Energy Community and incorporating Directive (EU) 2018/2001, Directive (EU) 2018/2002, Regulation (EU) 2018/1999, Delegated Regulation (EU) 2020/1044, and Implementing Regulation (EU) 2020/1208 in the Energy Community acquis communautaire, Nëntor 2021.

¹²Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Transposition and implementation of the Governance Regulation, Grupi Punues Teknik i Energjisë dhe Klimës, 7 prill 2022.

¹³Shqipëria adoptoi gjithashtu PKEK-në e saj, duke u zotuar njëkohësisht ta përditësojë atë së shpejti për të marrë parasysh komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Albania: The first Contracting Party to adopt National Energy and Climate Plan, 4 shkurt 2022.

¹⁴Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, WB6 Energy Transition Tracker, Qershor 2021.

¹⁵Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, mars 2017.

PKEK-të duhet të ndjekin një format të caktuar¹⁶ dhe secila duhet të mbulojë pesë shtyllat e politikës së BE-së për Unionin e Energjisë:

- Siguria e energjisë, solidariteti dhe besimi;
- Tregu plotësisht i integruar i brendshëm i energjisë;
- Eficienca e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës;
- Dekarbonizimi i ekonomisë; dhe
- Kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria

Secila prej tyre paraqet një sfidë për Kosovën, sektori i energjisë i së cilës është në udhëkryq dhe kërkon vendime gjithnjë e më urgjente se si të ecet përpara.

Kosova ka furnizimin me energji elektrike më të varur nga thëngjilli në Ballkanin Perëndimor, me 95 për qind të energjisë elektrike të gjeneruar nga thëngjilli në vitin 2020.¹⁷ Fatkeqësisht, në vend të investimit në kursimin e energjisë dhe lëvizjes me vendosmëri drejt burimeve të ripërtëritshme, Kosova e treti më shumë se një dekadë duke bërë përpjekje për të ndërtuar një termocentral të ri me djegie thëngjilli me kapacitet prodhues prej 500 MW,¹⁸ Kosova e Re, që doli të ishte një rrugë pa krye dhe u anulua në mars 2020.

Qeveritë e mëparshme gjithashtu kryesisht u orvatën për të përmbushur caqet e vendit për energjinë e ripërtëritshme për vitin 2020, duke ndërtuar hidrocentrale të reja.¹⁹ Ishin planifikuar deri në 280 megavatë (MW) kapacitete të hidrocentraleve të reja 'të vogla' (d.m.th., me më pak se 10 MW).²⁰ Në realitet, deri në fund të vitit 2021, u ndërtuan rreth 83 MW kapacitete të hidrocentraleve të vogla e të reja dhe u rinovuan edhe disa centrale të vjetra.²¹ Madje edhe centralet e reja me kapacitete prodhuese prej 83 MW shkaktuan polemika të mëdha, kështu që është e paqartë se si dikush mendonte se 280 MW do të ishin të realizueshme.

Kjo përvojë tregon rëndësinë e kryerjes së planifikimit të energjisë bazuar në të dhëna realiste dhe të përditësuara, duke integruar çështjet mjedisore në proces që nga fillimi, dhe duke përfshirë publikun për të krijuar mbështetje, për të marrë vendime më cilësore dhe për të shmangur befasi të pakëndshme më vonë.

Ky dokument i pozicionit synon të ofrojë rekomandime për PKEK-në e Kosovës, që aktualisht është duke u përgatitur, nga pikëpamja e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përfshirjes publike. Është pozitive që në grupin punues për hartimin e Planit janë përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile. Megjithatë, ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) ende nuk siguron që VSM-të të kryhen paralelisht me përgatitjen e planit ose programit që i nënshtrohet një VSM-je, përpara dorëzimit të tij në procedurën legjislative.²² Kjo duhet të bëhet me PKEK-në, nëse synohet të sigurohet që pjesëmarrja publike të jetë e hershme dhe efektive. Kjo do të ndihmonte që Kosova të planifikojë zgjidhje të dëshmuara dhe të pranueshme mjedisore dhe shoqërore dhe të shmangë shpërqendrimin në politika të cilat më vonë mund të rezultojnë të jenë kundërproduktive.

¹⁶ Policy Guidelines by the Energy Community Secretariat on the development of National Energy and Climate Plans under Recommendation 2018/01/MC-EnC PG.03/2018, Qershor 2018

¹⁷ Statistikat e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA), Kosovo, Electricity, 2020, qasur më 4 prill 2020.

¹⁸ Shpesh u përmend një kapacitet prej 450 MW; megjithatë, ky ishte kapaciteti neto dhe jo bruto.

¹⁹ Për të përmbushur cakun e saj të detyrueshëm prej 25 për qind, Kosova fillimisht planifikoi 97 MW nga hidrocentrale të reja të vogla (nën 10 MW) dhe 305 MW nga hidrocentrale të reja të mëdha. Por ajo vendosi gjithashtu një cak vullnetar prej 29.47 që përfshin rreth 240 MW nga hidrocentrale të reja të vogla. Në vitin 2017, qeveria nxori një Udhëzim Administrativ që përmban një cak të ri vullnetar dhe akoma më shumë hidrocentrale të vogla të reja - rreth 280 MW. Burimet: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosova: Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011-2020, 2013. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë, Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

²⁰ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë, Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

²¹ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

²² Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Implementation Report 2021, Nëntor 2021.

Siguria e energjisë, solidariteti dhe besimi

Kosova duhet të shmangë varësinë nga gazi dhe të ulë varësinë e saj nga importi i naftës

BE-ja ka vite që po përpiqet të diversifikojë burimet e saj të energjisë, veçanërisht naftën dhe gazin, për të cilat është shumë e varur nga importi.²³ Këtu Kosova ka një avantazh: megjithëse të gjitha produktet e saj të naftës importohen, ajo nuk është e varur nga gazi i importuar sepse gazi nuk përdoret gjerësisht dhe nuk ka rrjet të transmetimit apo shpërndarjes. Varësia neto e Kosovës nga importi i energjisë ishte 29.5 për qind në vitin 2020, krahasuar me mesataren e BE për të njëjtin vit prej 57.5 për qind.²⁴

Në vitet e fundit, janë bërë propozime të ndryshme që Kosova të ndërtojë infrastrukturën e importit të gazit fosil dhe të përdorë gazin për të zëvendësuar thëngjillin për gjenerimin e energjisë elektrike dhe për ngrohje. Gazsjellësit kryesorë të propozuar janë ALKOGAP,²⁵ i cili do të sillte gazin fosil të Azerbajxhanit nga Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) në Shqipëri, dhe interkonektori Maqedoni e Veriut-Kosovë,²⁶ që teorikisht gjithashtu do të sillte gaz nga TAP, por vetëm nëse ndërtohet fillimisht interkonektori Greqi-Maqedoni e Veriut.

Kjo infrastrukturë gazi do të duhej të ndërtohej nga e para, gjë që do të kushtonte dhe do të kërkonte vite. Kjo do të devijonte burimet nga investimi në eficientësinë e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të qëndrueshme. Koha që është dashur për të filluar zhvillimi i energjisë solare dhe të erës në Kosovë tregon se nuk është realiste të pritet – nëse realizohen investimet në gaz – që Kosova të bëjë një tranzicion tjetër nga gazi drejt burimeve të ripërtëritshme deri në vitin 2050.

Për momentin, për shkak të krizës së çmimit të gazit dhe pushtimit rus në Ukrainë, BE-ja po has në telashe të largohet nga gazi, veçanërisht gazi rus, me një ritëm të përshpejtuar. Rritja e shpejtë e çmimit të gazit në muajt e fundit ka ekspozuar rreziqet e varësisë nga gazi²⁷, pavarësisht nga burimi.

Përveç kësaj, gazsjellësit e planifikuar për në Kosovë do të përdornin gazin azerbajxhanas nga fusha Shah Deniz, por kompania ruse Lukoil zotëron 20 për qind të aksioneve në këtë projekt,²⁸ kështu që ende rezulton në mbështetje për Rusinë nëpërmjet tatimeve të Lukoil. Edhe nëse kjo ndryshon, nuk ka kuptim të rritet varësia nga energjia e importuar, veçanërisht nga regjimet autokratike dhe represive si ai i Azerbajxhanit.²⁹

Në dritën e kësaj, si dhe të urgjencës globale të klimës, përdorimi i ulët i gazit në Kosovë nuk duhet të shihet më si një 'mangësi' por si një përparësi.

Edhe nëse Kosova ndërton infrastrukturën e gazit, nuk është e sigurt fare nëse konsumatorët do të jenë të gatshëm ose në gjendje të absorbojnë kosto të larta dhe çmime të paqëndrueshme për gazin, kështu që normat e kyçjes mund të mos jenë aq të larta sa pritet, duke i lënë gazsjellësit si investime të humbura – të ashtuquajtura 'asete të bllokuara'. Edhe nëse përdoret gazi, ka të ngjarë që qeveria të duhet ta subvencionojë atë gjatë periudhave me çmime të larta, duke e ngarkuar më shumë buxhetin e shtetit.

²³ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee, the Committee of the Regions and the European Investment Bank: A Framework Strategy for a Resilient Energy Union with a Forward-Looking, 2015.

²⁴ Eurostat, Energy Dependence %, Table T2020_RD320_përditësuar për herë të fundit më 8 shkurt 2021.

²⁵ Komiteti i Energjisë, Albania-Kosovo Gas Pipeline (ALKOGAP), qasur më 4 prill 2022.

²⁶ Komiteti i Energjisë, North Macedonia-Kosovo interconnector, qasur më 4 prill 2022.

²⁷ Komisioni Evropian, REPowerEU: Joint European action for more affordable, secure and sustainable energy, 8 mars 2022.

²⁸ Lukoil, Lukoil completes the deal on acquiring interest in Shah-Deniz project, 18 shkurt 2022.

²⁹ Shih për shembull Freedom House, Azerbaijan, dhe Human Rights Watch, Azerbaijan, qasur të dy më 4 prill 2022.

Rekomandim: Vendimi i Kosovës për të mos zbatuar projektin e gazsjellësit nga Maqedonia e Veriut në vitin 2021, të paktën tash për tash,³⁰ ishte me vend, dhe do të duhej të çimentohet në PKEK-në e saj. Kosova do të duhej të shmangë plotësisht varësinë nga gazi dhe në vend të kësaj të bëjë një kërcim drejt elektrifikimit të bazuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë brenda vendit.

Për sa i përket naftës, ndërsa Kosova ndërton sektorin e saj energjetik bazuar në format e qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme, ajo do të duhej gjithashtu të lëvizë drejt elektrifikimit të transportit dhe përmirësimit të transportit publik, në mënyrë që të ulë varësinë nga nafta e importuar dhe të promovojë ajër më të pastër.

Si pjesë e caqeve të saj për vitin 2020, BE-ja promovoi përdorimin e biokarburanteve në transport, mirëpo kjo politikë ka rezultuar kundërproduktive.³¹ Rritja e kërkesës për biokarburantet me prejardhje ushqimore kërkon më shumë tokë bujqësore. Meqenëse pjesa më e madhe e tokës bujqësore në nivel global tashmë po përdoret, duhen gjetur sipërfaqe të reja, gjë që çon në shpyllëzim, duke çliruar tonelata të gazeve me efekt serrë. Në disa raste, këto shkarkime janë aq të mëdha sa që disa biokarburante çojnë në shkarkime më të mëdha të gazeve me efekt serrë sesa karburantet fosile që ato zëvendësojnë, kur merret parasysh i gjithë cikli i jetës së bimës. Ky është rasti për biodizelin e përfutur nga vajrat bimore si vaji i kolëzes, i palmës, i sojës dhe i lulediellit.³²

Direktiva e BE-së për Energjinë e Ripërtëritshme e vitit 2018 prandaj kufizon biokarburantet me bazë bimore në nivelet e përdorimit nga çdo shtet anëtar i BE-së në vitin 2020 – një ngrirje de facto. BE-ja gjithashtu do të bëjë heqjen graduale të biokarburanteve me risk të lartë shpyllëzimi deri në vitin 2030. Direktiva e BE-së për energjinë e ripërtëritshme është aktualisht përsëri në rishikim, kështu që situata ka të ngjarë të ndryshojë më tej.

Rekomandim: Për t'u larguar nga varësia nga nafta, Kosova këshillohet të ndjekë elektrifikimin e transportit si dhe përmirësimin e transportit të saj publik (shih seksionin Dekarbonizimi), gjë që do të ndihmonte në uljen e kërkesës nga automjetet individuale. Kosova nuk këshillohet të ndjekë biokarburantet si alternativë ndaj produkteve të naftës për transport.

Situata është e ngjashme me hidrogjenin, i cili gjithashtu po promovohet shumë nga Komisioni Evropian për momentin.³³ Ideja është që hidrogjeni i prodhuar duke përdorur energji të ripërtëritshme mund të përdoret si lëndë djegëse dhe kështu të ndihmojë në zëvendësimin e produkteve të naftës. Gjithsesi ka të ngjarë që hidrogjeni të luajë një rol në të ardhmen për sektorët që nuk mund të funksionojnë lehtësisht me energji elektrike – për shembull për aeroplanët dhe kamionët e mëdhenj dhe disa industri të rënda.

Megjithatë, për momentin, 96 për qind e hidrogjenit prodhohet duke përdorur gaz fosil,³⁶ dhe procesi i prodhimit shpenzon shumë energji, kështu që është thelbësore që hidrogjeni i përdorur të përftohet nga burime të ripërtëritshme.

³⁰Igor Todorović, [Kosovo shelves US-backed gas pipeline project](#), Balkan Green Energy News, 5 tetor 2021.

³¹Transport&Environment, [Biofuels, qasur më 4 prill 2022](#).

³²Transport&Environment, [Biofuels, qasur më 4 prill 2022](#).

³³Directive (EU) 2018/2001 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 on the promotion of the use of energy from renewable sources

³⁴Transport&Environment, [Biofuels, qasur më 4 prill 2022](#).

³⁵Shih Komisioni Evropian, [Hydrogen, qasur më 4 prill 2022, për disa nga nismat e BE-së në lidhje me hidrogjenin](#).

³⁶Shih Komisioni Evropian, [Hydrogen, qasur më 4 prill 2022, për disa nga nismat e BE-së në lidhje me hidrogjenin](#).

Përveç kësaj, ka të ngjarë të ketë konkurrencë të fortë për energjinë e ripërtëritshme në vitet e ardhshme, pasi ajo do të përdoret gjithnjë e më shumë për ngrohje dhe transport. Prandaj, ka shumë pak gjasa që hidrogjeni i ripërtëritshëm të jetë i disponueshëm me një çmim të përballeshëm.

Rekomandim: Kosovës i rekomandohet që së pari të përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme dhe elektrifikimin e ngrohjes dhe transportit, dhe vetëm më pas të shqyrtojë rolin e mundshëm të hidrogjenit për sektorët e vështirë për t'u dekarbonizuar, pasi të jetë bërë më i qartë në BE roli i hidrogjenit dhe pasi të jenë ulur kostot e hidrogjenit të ripërtëritshëm.

Thëngjilli nuk do të jetë një rrugë drejt sigurisë energjetike

Rezervat e brendshme të thëngjillit në Kosovë aktualisht kontribuojnë në varësinë relativisht të ulët të vendit nga importi, mirëpo përdorimi i thëngjillit shkakton kosto të shumta dhe shumë të larta për shëndetin e njeriut, mjedisin dhe klimën.³⁷ Gjithashtu po bëhet gjithnjë e më joekonomike edhe në aspektin financiar, dhe kjo është arsyeja pse gjenerimi i energjisë elektrike me djegie të thëngjillit është ulur ndjeshëm në BE vitet e fundit.³⁸ Legjislacioni i BE-së për kontrollin e ndotjes – që synon ndër të tjera parandalimin e vdekjeve – nënkupton që operatorët e centraleve me djegie të thëngjillit tani duhet të paguajnë për disa nga ndikimet mjedisore të thëngjillit, duke instaluar pajisje për kontrollin e ndotjes dhe duke paguar për shkarkimet e gazeve me efekt serrë.³⁹ Burimet solare dhe të erës nuk shkaktojnë kosto të tilla dhe për këtë arsye mund të prodhojnë me një çmim më konkurrues se sa centralet e reja të thëngjillit.

Eliminimi i thëngjillit është ngadalësuar përkohësisht për shkak të krizës së çmimit të gazit në dimrin 2021-2022, por kjo nuk do të thotë se thëngjilli ka një perspektivë afatgjatë. Fakti që thëngjilli tani është më i lirë se gazi nuk e ndryshon faktin se është shumë më i shtrenjtë se energjia nga burimet solare dhe të erës në BE, por vendet evropiane thjesht nuk kanë bërë ende sa duhet për të instaluar energji të ripërtëritshme dhe për të kursyer energjinë.⁴⁰

Ndërsa Kosova përparon drejt aderimit në BE, ajo do të duhet të aplikojë çmimin e karbonit. Kjo do të thotë që prodhuesit e energjisë elektrike dhe disa impiante industriale do të duhet të paguajnë për çdo ton dyoksid karboni që shkarkojnë. Në nëntor 2021, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë miratoi një Udhërrëfyes të Dekarbonizimit,⁴¹ duke përcaktuar afatet kohore indikative për futjen e çmimit të karbonit. Nëse gjithçka shkon sipas planit, kjo do të çonte në futjen e çmimit të karbonit rreth vitit 2025. Kjo do ta bëjë jokonkurrues gjenerimin e energjisë elektrike me djegie thëngjilli, madje edhe nga termocentralet ekzistuese.

Në muajt e fundit, Kosova ka filluar të eksportojë linjit në Maqedoninë e Veriut për shkak të problemeve të furnizimit me thëngjill në termocentralin me djegie thëngjilli në Manastir.⁴² Por Kosova nuk do të duhej të llogarisë në këtë si një burim afatgjatë të ardhurash, pasi Maqedonia e Veriut është zotuar për heqjen graduale të thëngjillit deri në vitin 2027.⁴³

³⁷ CEE Bankwatch Network, [Comply or Close, 7 shtator 2021](#).

³⁸ Charles Moore, [European Electricity Review 2022](#), Ember, 1 shkurt 2022.

³⁹ Për shkak të [Directive 2010/75/EU of the European Parliament and the Council on industrial emissions](#) dhe [Directive 2003/87/EC of the European Parliament and of the Council of 13 October 2003 establishing a system for greenhouse gas emission allowance trading within the Union](#).

⁴⁰ Charles Moore, [European Electricity Review 2022](#), Ember, 1 shkurt 2022.

⁴¹ Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, [General Policy Guidelines 01/2021/MC-EnC Decarbonisation Roadmap for the Contracting Parties of the Energy Community](#), Nëntor 2021.

⁴² Valentina Dimitrievska, [Crisis highlights weaknesses of North Macedonia's energy system](#), BNE Intelligence, 1 shkurt 2022.

⁴³ Europe Beyond Coal, [Spain and North Macedonia commit to exit coal by 2030](#), 30 qershor 2021.

Në fillim të prillit 2022, deklaratat e ministres së energjisë konfirmuan se Kosova nuk do të ndërtojë termocentrale të reja me thëngjill, por sugjeruan se një ose më shumë blloqe të Termocentralit Kosova A do të duhej të avancohen.⁴⁴ Shtrirja e saktë e këtij 'avancimi' është e paqartë, por nëse çon në funksionimin e termocentralit për më shumë se 2-3 vjet të tjera, avancimi nuk do të duhej të ndërmerret.

Rekomandim: Jo vetëm për arsye shëndetësore, mjedisore dhe klimatike, por edhe për arsye ekonomike, Kosova këshillohet që të heqë gradualisht përdorimin e thëngjillit sa më shpejt që të jetë e mundur teknikisht për ta bërë këtë, duke filluar me Termocentralin Kosova A i cili duhet të mbyllet urgjentisht. Ndërkohë nuk do të duhej të ndërmerren avancime përtej mirëmbajtjes së rregullt.

Tregu plotësisht i integruar i brendshëm i energjisë

Kapaciteti prodhues i energjisë elektrike në Kosovë mund të përmbushë pothuajse plotësisht kërkesën e brendshme shumicën e viteve (shih grafikun në seksionin Dekarbonizimi, më poshtë), por është e vështirë të përshtatet shpejt gjenerimi me kërkesën për shkak të varësisë së vendit nga thëngjilli dhe faktit që termocentralet me thëngjill nuk mund të ndizen dhe fiken shpejt.

Sot, Kosova ka koneksione të mira me të gjitha vendet fqinje me të paktën një transmetim prej 400 kV me secilin. Me rëndësi të veçantë është linja e re e transmetimit që lidh Kosovën me Shqipërinë e varur nga hidrocentralet, që ndihmon në balancimin e sistemit jofleksibil të Kosovës.

Një studim i Komunitetit të Energjisë i vitit 2021 konstatoi se vendet e Ballkanit Perëndimor do të duhej të përqendroheshin në përdorimin e kapaciteteve ekzistuese të transmetimit ndërkufitar në mënyrë më eficiente, në vend që të ndërtojnë më shumë linja të reja,⁴⁵ gjë që vlen shumë për Kosovën pasi mungesa e alokimit të kapaciteteve transmetuese nga operatori i rrjetit të Serbisë ka kontribuar gjithashtu në vështirësitë e furnizimit me energji elektrike të Kosovës gjatë dimrit 2021-2022.⁴⁶ Është e vështirë që PKEK-ja e Kosovës të trajtojë vetë kapacitetin transmetues nga Serbia, pasi kjo ka të bëjë me çështje më të gjera ndërmjet vendeve, por do të duhej t'i kushtohet vëmendje mënyrës se si të anashkalohej kjo çështje.

Në prill 2020, operatori i transmisionit i Kosovës nënshkroi një marrëveshje me ENTSO-E për të dalë nga Blloku Rregullues Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut për t'iu bashkuar një Blloku Rregullues të ri të sistemeve energjetike Kosovë-Shqipëri, duke i hapur kështu rrugën pjesëmarrjes në bursën e energjisë me Shqipërinë.⁴⁷

Një bursë e përbashkët e energjisë – ALPEX - u themelua në tetor 2020 nga operatori i sistemit të transmetimit (OST) i Shqipërisë dhe i Kosovës (KOSTT). Aktualisht po punohet për ngritjen e një tregu për operim një ditë përpara (D-1) dhe brenda-ditor (D) për energjinë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë, ku nisja e tregut është planifikuar aktualisht për tremujorin e katërt të 2022.⁴⁸ Kjo është thelbësore për të mundësuar integrimin e një pjese të madhe të burimeve të ripërtëritshme të ndryshueshme, siç janë burimet solare dhe të erës, në miksin e energjisë elektrike të të dy vendeve.

⁴⁴ Igor Todorović, Rizvanolli: No new coal plants in Kosovo's draft energy strategy, Balkan Green Energy News, 4 prill 2022.

⁴⁵ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Electricity Interconnection Targets in the Energy Community Contracting Parties, Shkurt 2021.

⁴⁶ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

⁴⁷ Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Marrëveshja në mes KOSTT dhe ENTSO-E, pavarësim elektro-energjetik i Kosovës nga Serbia, 21 prill 2020.

⁴⁸ Dragana Petrushevska, Albania-Kosovo power exchange ALPEX joins Europex, SEEnews, 2 shkurt 2022.

Burimet e gjenerimit që nuk punojnë gjatë gjithë kohës mund të akomodohen në një sistem fleksibil ku energjia elektrike mund të blihet dhe shitet shpejt dhe burime të tjera, si hidrocentralet ekzistuese ose bateritë, mund të rrisin ose ulin shpejt prodhimin. Por është e vështirë të përfshihen sasi të mëdha të burimeve të ripërtëritshme në një sistem siç është aktualisht ai i Kosovës, me një përqindje të lartë të energjisë së prodhuar me djegie thëngjilli nga termocentrale që nuk mund të ndizen dhe fiken shpejt. Kosova tashmë mund të përfshijë akoma më shumë energji të ripërtëritshme në sistemin e saj, por për të ardhmen tregjet e hapura do të jenë thelbësore. Kjo do të ndihmojë gjithashtu për të arritur çmimin më të favorshëm të mundshëm të energjisë elektrike në çdo kohë të caktuar, sepse ekziston një zgjedhje më e madhe e burimeve potenciale të gjenerimit të energjisë elektrike nga të cilat mund të bëhen blerje me një paralajmërim të shkurtër.


Rekomandim: Kosova dhe Shqipëria kanë bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e një tregu të përbashkët të energjisë elektrike dhe do të duhej të vazhdojnë punën në këtë drejtim, si një parakusht i rëndësishëm për arritjen e një përqindjeje të madhe të energjisë së ripërtëritshme të ndryshme.

Eficientia e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës

Ashtu si vendet që krahasohen me të, Kosova e përdor energjinë në mënyrë joeficiente – shpenzon katër herë më shumë energji sesa mesatarja e BE-së,⁴⁹ që do të thotë se nevojitet katër herë më shumë energji se sa në BE për të gjeneruar një njësi të Bruto Produktit Vendor. Kjo vlen për të gjitha llojet e energjisë, duke përfshirë energjinë elektrike, e cila përdoret shpesh për ngrohjen e hapësirave me ngrohës të vjetër dhe joeficientë.

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë ka mbetur i qëndrueshëm ndërmjet viteve 2010-2018 – pavarësisht parashikimeve se do të rritet ndjeshëm⁵⁰ – por më pas filloi të rritet, veçanërisht në vitin 2021.⁵¹

Figura 1: Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë



Burimi: [Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2021](#)

⁴⁹ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, [Total energy supply \(TES\) by GDP, Kosovo, 1990-2019, dhe Total energy supply \(TES\) by GDP, EU-28, 1990-2019, IEA Data and Statistics, qasur për herë të fundit më 3 prill 2022.](#)

⁵⁰ Strategjia e Kosovës për Energjinë e vitit 2009 kishte parashikuar kërkesë prej 6,939 GWh në vitin 2018 në skenarin e kërkesës së mesme, ndërsa në realitet kërkesa arriti në 5,671 GWh. Burimet: Qeveria e Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Minierave, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, 2009: Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.](#)

⁵¹ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.](#)

Një pjesë e arsyes për këtë rritje duket se kanë qenë ndryshimet në strukturën tarifore në vitin 2017, të cilat nuk nxitën efikasitetin e energjisë, sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji.⁵² Por përdorimi i energjisë elektrike nga disa konsumatorë pa paguar për të (shih më poshtë) me sa duket inkurajon gjithashtu konsumin shkapërdar. Në mes të krizës energjetike 2021-2022 në Kosovë filloi të dalë në pah shkalla e mihjes së kriptomonedhave, gjë që mund të ketë kontribuar në këtë rritje, pasi është një aktivitet që shpenzon shumë energji elektrike.⁵³ Në janar 2022, nën masat e emergjencës për të trajtuar krizën, qeveria shpalli një ndalim të mihjes së kriptomonedhave.⁵⁴

Në vitet që vijnë, do të ketë kontraste në trendet e konsumin e energjisë. Siç është eksploruar më poshtë, ka një hapësirë të madhe për kursime dhe elektrifikimi i ngrohjes duke përdorur pompat termike do të kursejë energji në krahasim me mënyrat aktuale të ngrohjes me energji elektrike, edhe nëse adoptohet nga një pjesë e madhe e konsumatorëve shtëpiakë. Nga ana tjetër, do të nevojitet energji elektrike shtesë për elektrifikimin e transportit, gjë që do të rrisë kërkesën. Prandaj është thelbësore të sigurohet që të ndërmerren të gjitha veprimet e mundshme për të kursyer energjinë elektrike dhe për të shmangur konsumin më të lartë sesa duhet.

Trajtimi i rrjetit të energjisë elektrike dhe i humbjeve komerciale

Humbjet në rrjetin e transmetimit janë 1.75 për qind, por humbjet në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2021 ende ishin gati 25 për qind, rreth gjysma e të cilave ishin humbje teknike dhe gjysma ishin humbje komerciale – d.m.th., përdorimi i energjisë elektrike pa paguar për të.⁵⁵ Pothuajse gjysma e energjisë elektrike që furnizohet në veri të Kosovës llogaritet si humbje komerciale, por ky rajon numëron pak më pak se gjysmën e humbjeve të tilla,⁵⁶ kështu që problemi është në mbarë vendin.

Për vite të tëra, humbjet në veri u faturoheshin konsumatorëve në pjesën tjetër të Kosovës, por një vendim gjyqësor e ndaloi këtë praktikë në fund të vitit 2017 dhe derisa të zgjidhet çështja e furnizimit në veri, KOSTT për momentin po i mbulon kostot, të cilat arritën në mbi 41 milionë euro deri në vitin 2021.⁵⁷ Licencimi i një subjekti të ri për të kryer furnizimin me energji elektrike në veri është në proces e sipër që nga marsi 2022.⁵⁸

Rekomandime: Të vendosen caqe më ambicioze në PKEK për të përshejtuar punën e KEDS-it për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes për të reduktuar humbjet teknike, dhe të përkufizohet struktura dhe burimet e mundshme të financimit.

Të vendosen caqe ambicioze për futjen e shpejtë në përdorim të njehsorëve inteligjentë. Përvoja e Malit të Zi me projektin e njehsorëve inteligjentë të financuar nga BERZH mund të jetë e dobishme – të paktën jashtë veriut të Kosovës – pasi ndihmoi në trajtimin e mospagesës për konsumin e energjisë elektrike.⁵⁹

⁵² Zyra e Rregullatorit për Energji, Komunikatë për media, Publikimi i raportit konsultativ për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike, 17 janar 2022.

⁵³ Alice Taylor, [Kosovo bans crypto-mining amid energy crisis](#), *Exit, all/Euractiv*, 5 janar 2022.

⁵⁴ Alice Taylor, [Kosovo bans crypto-mining amid energy crisis](#), *Exit, all/Euractiv*, 5 janar 2022.

⁵⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

⁵⁶ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

⁵⁷ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

⁵⁸ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

⁵⁹ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, [EPCG Metering and Distribution Project](#), 22 dhjetor 2021.

Izolimi i banesave, pompat termike dhe kapacitetet solare për ngrohje të ujit për efikasitet të energjisë

Çmimet e energjisë mbahen artificialisht të ulëta për konsumatorët fundorë në Kosovë – d.m.th., ato janë të rregulluara dhe nuk mbulojnë medoemos kostot e gjenerimit, importit, mirëmbajtjes apo investimeve të tjera të bëra nga prodhuesit e energjisë. Prandaj, këtu ka pak nxitje për të përdorur energjinë me kursim ose për të investuar në izolim. Edhe nëse çmimi për-njësi është i ulët, qytetarët mund të kenë ende vështirësi për të bërë pagesën e faturave për shkak të përdorimit të madh të energjisë elektrike – veçanërisht nëse e përdorin atë për ngrohje. Në vitin 2018, viti i fundit për të cilin janë siguruar të dhëna, 56.7 për qind e qytetarëve konsideroheshin me risk për varfëri ose përjashtim social,⁶⁰ kështu që edhe këta qytetarë kanë vështirësi për të bërë pagesën e faturave, por janë më së paku në gjendje të investojnë për uljen e mëtejshme të konsumit të tyre.⁶¹

Spektori banesor është përgjegjës për pjesën më të madhe të konsumit total final të energjisë dhe ka potencial të madh për përmirësime.⁶² Forma më e zakonshme e ngrohjes për shtëpitë individuale është druri dhe pas tij renditet energjia elektrike. Ka pak informacion në dispozicion për ngrohjen e banesave/shtëpive në vetvete, por konsumi i përgjithshëm i energjisë nga ekonomitë familjare në vitin 2020 dominohej nga druri, me 58 për qind, pasuar nga energjia elektrike me 38 për qind.⁶³ Duke pasur parasysh se energjia elektrike përdoret për një sërë qëllimesh të tjera përveç ngrohjes, kjo mbase do të thotë që përqindja reale e përdorimit të drurit për ngrohje është më e lartë dhe përdorimi i energjisë elektrike është më i ulët. Përveç kësaj, në mënyrë anekdotike është e qartë se disa ekonomi familjare përdorin thëngjillin për ngrohje dhe se gjithashtu ka mihje të paligjshme të thëngjillit në Kosovë.

Druri klasifikohet si energji e ripërtëritshme sipas Direktivës së BE-së për Energjinë e Ripërtëritshme⁶⁴ sepse pemët e reja mund të zëvendësojnë drurin e djegur. Megjithatë, burimet e ripërtëritshme nuk janë të njëjta me burimet e qëndrueshme mjedisore, siç e ka zbuluar tashmë Kosova. Sipas të dhënave satelitore, midis viteve 2000 dhe 2019 vendi humbi rreth 7,618 hektarë pyje, sipërfaqe e barasvlershme me rreth 1.5 fusha futbollit në ditë.⁶⁵ Ndonëse nuk ka në dispozicion një zberthim të saktë të përdorimit fundor të drurit, duke pasur parasysh përdorimin e përhapur të drurit të zjarrit për ngrohje, është e arsyeshme të supozohet se pjesa më e madhe e drurit është djegur në ekonomitë familjare.

Prandaj është thelbësore të gjenden mjete më efikasitet për ngrohje, në mënyrë që të përdoren më pak druri dhe energjia elektrike. Termoizolimi i banesave është masa më e rëndësishme për të ulur kërkesën në radhë të parë.

Shpesh thuhet se efikasiteti e energjisë duhet të jetë karburanti i parë, por në realitet nuk ka qenë kështu, as në BE dhe as në Ballkanin Perëndimor, dhe kjo duhet të ndryshojë. Kosova ka punuar në efikasitetin e energjisë duke adoptuar legjislacionin zbatues për performancën energjetike të ndërtesave në vitin 2020 dhe duke forcuar ekspertizën e saj për certifikimin e ndërtesave. Janë hartuar gjithashtu një plan për të rritur numrin e ndërtesave me energji pothuajse zero dhe një strategji për rinovimin e ndërtesave,⁶⁶ por me sa di autori, këto ende nuk janë adoptuar.

Në vitin 2019 u krijua një Fond për Efikasitetin e Energjisë, me rreth 20 milionë euro dhe financim të siguruar deri në vitin 2022. Deri më tani ai ka financuar vetëm efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike, por ka plane për të shtrirë financimin në sektorin e banimit,⁶⁷ gjë që është thelbësore për të përhapur përfitimet më gjerësisht.

⁶⁰ Eurostat, [People at risk of poverty or social exclusion \(LIC_PEPS01\)](#), qasur më 3 prill 2022.

⁶¹ Ka shumë pak informacion në dispozicion për varfërinë energjetike në Kosovë, pasi koncepti i 'konsumatorëve nevojtarë' është përcaktuar me ligj, por nuk ka statistika të detajuara në dispozicion. Shih Energy Institute Hrvoje Požar and DOOR, [Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties](#), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Dhjetor 2021.

⁶² Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA), [Share of total final consumption \(TFC\) by sector, Kosovo, 2000-2019](#), IEA Data and Statistics, qasur për herë të fundit më 3 prill 2022.

⁶³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Bilanci i Energjisë 2020](#), qershor 2021. Kjo u konfirmua edhe nga një anketë e porositur nga RES Foundation, i cili megjithatë nuk e përcaktoi sasinë e përdorimit të energjisë elektrike, RES Foundation, [Summary of the research on heating practices in the residential sector of Kosovo](#), Nëntor 2021.

⁶⁴ Neni 2, [Directive \(EU\) 2018/2001 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 on the promotion of the use of energy from renewable sources](#).

⁶⁵ Sustainability Leadership Kosova, [#MoseMerrMalin](#), qasur më 4 prill 2022.

⁶⁶ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Implementation Report 2021](#), Nëntor 2021.

⁶⁷ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Implementation Report 2021](#), Nëntor 2021.

Përdorimi i drurit në mënyrë më eficiente mund të luajë rol ndryshues – d.m.th., përdorimi i shporeteve më eficiente dhe përdorimi i drurit të thatë dhe të regjur. Shumë qytetarë në Kosovë nuk janë të vetëdijshëm për nevojën, ose nuk kanë mundësi të blejnë dru mjaftueshëm paraprakisht, për të siguruar tharjen e duhur të drurit.⁶⁸ Megjithatë, kjo më vete nuk do të mjaftojë. Kosova do të duhet të ndërmarrë hapa për të nxitur një ndryshim në praktikat e ngrohjes në ekonomitë familjare individuale.

Viteve të fundit, peleti drusor është bërë i popullarizuar në Kosovë,⁶⁹ dhe kur digjet në një stufë të projektuar enkas, është mjaft eficient për përdoruesin fundor. Ideja është që peleti prodhohet nga mbetjet e industrisë së drurit, megjithatë në realitet, ekziston një furnizim i kufizuar i mbetjeve të tilla drusore, kështu që është pothuajse e pamundur të sigurohet që të mos përdoren pemë të tëra. Në shumë raste, industria e peletit drusor ka shumë të ngjarë të çojë në shpyllëzim dhe është e diskutueshme nëse ajo po redukton madje shkarkimet e gazeve me efekt serrë në krahasim me djegien e lëndëve djegëse fosile.⁷⁰

Për këtë arsye, dhe për shkak të nevojës për të reduktuar sasinë e energjisë elektrike të përdorur për ngrohje, është më e arsyeshme që PKEK-ja të promovojë përdorimin e pompave termike për ndërtesat e banimit të cilat përdorin 4-5 më pak energji se sistemet e tjera të ngrohjes,⁷¹ si dhe panelet solare për ngrohje të ujit, gjë që mund të reduktojë nevojën për energji elektrike ose ngrohje me dru dhe është shumë kosto efektive. Edhe tani, ndërkohë që energjia elektrike furnizohet kryesisht nga thëngjilli, ka ende kuptim të promovohen pompat termike për shkak të përfitimeve të tyre të mëdha në efikasitet, veçanërisht në ato ekonomi familjare që tashmë përdorin energjinë elektrike për ngrohje. PKEK-ja e Shqipërisë⁷² nuk e ka shfrytëzuar maksimalisht këtë mundësi dhe Kosova do të duhej të shmangë përsëritjen e këtij gabimi.

Rekomandime: Të vazhdohet me adoptimin e strategjisë së rinovimit të ndërtesave edhe para adoptimit të PKEK-së.

Të identifkohen barrierat aktuale për përdorimin e pompave termike në ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla dhe të përcaktohen masat për kapërcimin e tyre në PKEK, duke përfshirë stimujt tatimorë.

Të sigurohet që Fondi i Efikasitetit të Energjisë ka burime të mjaftueshme për të financuar rinovimet e thella dhe instalimin e pompave termike dhe kapaciteteve solare si burim termik në sektorin e banimit. Financimi me grante duhet të marrë parasysh rezultatet dhe rekomandimet e studimit të porositur për projektin SEEK.⁷³

Të zhvillohen aktivitete të edukimit publik mbi nevojën për të tharë siç duhet drurin përpara përdorimit.

Të sigurohet që komunat janë mjaftueshëm të fuqizuara, të trajnuara dhe kanë burime për të çuar përpara masat e efikasitetit të energjisë në ekonomitë familjare.

⁶⁸ RES Foundation, [Summary of the research on heating practices in the residential sector of Kosovo](#), Nëntor 2021.

⁶⁹ Sipas Thes-Ari Recycling Industry Sh.P.K., në vitin 2016, stufat me pelet përbënin 75 për qind të të gjitha kaldajave të reja të shitura [Wood biomass for a sustainable future](#), janar 2017. Nuk kemi mundësi të gjejmë të dhëna më të fundit.

⁷⁰ Roger Drouin, [Wood Pellets: Green Energy or New Source of CO2 Emissions?](#), Yale Environment 360, Janar 2015; WWF, [500+ scientists tell EU to end tree burning for energy](#), 11 shkurt 2021.

⁷¹ BERZH, [Heat pumps: Enjoy a comfortable living environment while spending 4 to 5 times less energy](#), qasar më 5 prill 2022.

⁷² Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Energy Community and National Energy and Climate Plans](#), qasar më 5 prill 2022.

⁷³ GFA Consulting Group & HPC International, [Residential Buildings Efficiency Retrofits Baseline Study \(Final Draft\)](#), Subvencionet për Efikasitet të Energjisë në Kosovë (SEEK), Mars 2020 dhe GFA Consulting Group & HPC International, [Market Study \(Final Draft\)](#), Subvencionet për Efikasitet të Energjisë në Kosovë (SEEK), Prill 2020.

Ashtu si vendet e tjera në rajon, Kosova duhet të balancojë hapjen e tregjeve të saj – gjë që do të rezultojë në çmime më të larta të energjisë elektrike – me mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm. Çështja është gjithsesi e ndjeshme dhe Kosova ka parë protesta kur rregullatori i energjisë u përpoq të rriste çmimet.⁷⁴ Megjithatë, kjo është e pashmangshme dhe duhet bërë hap pas hapi, paralelisht me masat për të ndihmuar ata që nuk mund të paguajnë faturat e tyre.

Përpyekjet e deritanishme të Kosovës për të trajtuar varfërinë energjetike kanë konsistuar në ndihmën afatshkurtër për faturat e energjisë⁷⁵ elektrike për familjet nevojtare, por nuk i kanë ndihmuar ata të ulin konsumin e tyre duke rritur eficiencën e tyre të energjisë. Përpyekjet e tilla janë padyshim më të ndërlikuara dhe, në varësi nga çmimet e energjisë elektrike, gjithashtu potencialisht më të shtrenjta se pagimi i faturave të qytetarëve, por sjellin bashkë-përfitime të rëndësishme në drejtim të sigurimit të mbështetjes publike për tranzicionin energjetik.

Rekomandime: Të hartohet dhe të adoptohet një plan formal për të trajtuar varfërinë energjetike, bazuar në një qasje pjesëmarrëse ndaj përcaktimit të nevojave të qytetarëve. Kjo do të duhej të përfshijë sa vijon:

- auditime të eficiencës së energjisë dhe këshilla për ekonomitë familjare për masat që mund të merren pa asistencë profesionale (izolim nga rrymat e ajrit, ndriçim LED, etj.)
- duke shkuar përtej mbështetjes së të ardhurave për të përfshirë përmirësime të eficiencës së energjisë për familjet e cenueshme, përfshirë izolimin, ngrohjen më eficiente (mundësisht pompa termike, ose potencialisht ngrohje me dru, aty ku është më e përshtatshme) dhe instalimin e paneleve solare për ngrohje të ujit dhe/ose teknologjisë solare fotovoltaike për të reduktuar kostot.⁷⁶

Ndërmjet 3-5 për qind e kërkesës së Kosovës për ngrohje mbulohet gjithashtu nga ngrohja qendrore.⁷⁷ Kjo ofron hapësirë të konsiderueshme për eficiencë të energjisë dhe mbulohet më poshtë, në seksionin për dekarbonizimin e sektorit të ngrohjes.

⁷⁴ Eraldin Fazliu, [Protestohet kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike, Kosovo 2.0, 20 dhjetor 2017](#).

⁷⁵ Energy Institute Hrvje Požar and DOOR, [Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Dhjetor 2021](#).

⁷⁶ Më shumë hollësi jepen nga Energy Institute Hrvje Požar and DOOR, [Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Dhjetor 2021](#).

⁷⁷ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

Dekarbonizimi i ekonomisë

Ndërkohë që Kosova planifikon të anëtarësohet në BE, ajo duhet të arrijë dekarbonizimin e plotë deri në vitin 2050. Kosova e konfirmoi këtë qëllim duke nënshkruar Deklaratën e Sofjes në nëntor 2020.⁷⁸ Prandaj, PKEK-ja e parë e Kosovës është një hap i rëndësishëm në një proces shumë më të gjatë dhe caqet për vitin 2030 duhet ta vendosin atë në rrugën e duhur për vitin 2050.

I takon Kosovës që të përcaktojë caqet e veta, duke u udhëzuar nga një studim që po kryhet aktualisht për Komisionin Evropian. Drafti i parë i opsioneve për caqet e propozuara nga konsulentët u publikua në fillim të prillit 2022 dhe tani do të jetë subjekt i diskutimeve me qeveritë e Ballkanit Perëndimor.

	Arritjet 2020	Ambicia e ulët 2030	Ambicia e mesme 2030	Ambicia e lartë 2030
Energjia e ripërtëritshme (pjesa në konsumin final)	24.4 për qind (krahasuar me 18.9 për qind në 2009)	28.8 për qind	30.2 për qind	32.1 për qind
Eficiency e energjisë (krahasuar me projeksionin biznes-si-zakonish) ⁷⁹	Nuk mund të krahasohet	< -5 për qind konsumi final i energjisë (FEC) -2 për qind konsumi primar i energjisë (PEC)	< -5 për qind FEC -4 për qind PEC	< -5 për qind FEC -22 për qind PEC
Reduktimi i shkarkimeve të gazrave me efekt serrë (krahasuar me 1990)	Nuk dihet ⁸⁰	-12 për qind	-16.3 për qind	-40.3 për qind

Tabela 1: Opsionet e draftit të parë për caqet e vitit 2030. Burimi: E3 Modelling⁸¹ dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë⁸²

Pa parë llogaritjet që qëndrojnë prapa këtyre caqeve, është e vështirë të vlerësohet se sa ambicioze janë ato. Megjithatë, është e qartë se nëse Kosova arrin vetëm rreth 30 për qind të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2030, do të ketë ende një rrugë jashtëzakonisht të gjatë për të bërë deri në vitin 2050. Edhe pse një cak prej rreth 30 për qind është në përputhje me atë që u arrit midis 2009 dhe 2020, kjo nuk mjafton, veçanërisht duke pasur parasysh uljen e çmimit të energjisë solare dhe të erës ndërkohë, si dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjisë së pompave termike.

CAN Europe ka llogaritur se shkarkimet e gazrave me efekt serrë të Kosovës duhet të ulen nga 9.74 MtCO₂eq në 2018 në 4.7 MtCO₂eq deri në vitin 2030 në mënyrë që të jenë në përputhje me ambicien e Marrëveshjes së Parisit për të kufizuar ndryshimet klimatike në 1.5 gradë Celsius deri në mesin e shekullit në krahasim me epokën para-industriale,⁸³ por meqenëse caqet e propozuara nga konsulentët e KE-së janë paraqitur vetëm në përqindje në krahasim me vitin 1990, nuk është e mundur të vlerësohet nëse ato e përmbushin këtë synim.

⁷⁸ Regional Cooperation Council, [Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, 10 nëntor 2020](#).

⁷⁹ Vlerat e përafërta të bazuara në grafik - përqindjet nuk tregohen.

⁸⁰ Të dhënat e vitit 1990 për Kosovën nuk janë në dispozicion të publikut, megjithatë E3 me sa duket i ka llogaritur pasi i kanë krahasuar caqet e reja me të.

⁸¹ E3 Modelling, [Energy Community - project update, 7 prill 2022](#).

⁸² Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Energy Community meets 2020 headline target for energy efficiency, makes progress on renewables, 16 shkurt 2022](#).

⁸³ Climate Action Network Europe, [Western Balkans Greenhouse Gas Emission Reduction Targets 2030. The path to achieving carbon neutrality by 2050, Qershor 2021](#).

Rekomandime: Caku i Kosovës për reduktimin e shkarkimeve të gazrave me efekt serrë dhe caqet e efijencës së energjisë duhet të llogariten në një mënyrë që nuk vonon veprimet e rëndësishme për arritjen e dekarbonizimit deri pas vitit 2030, veçanërisht pasi shumë nga opsionet më të lehta për veprim janë në dispozicion tashmë në këtë dekadë.

Caku i Kosovës për energjinë e ripërtëritshme për vitin 2030 duhet të jetë kompatibil me arritjen e 100 për qind të burimeve të ripërtëritshme deri në vitin 2050. Kjo duhet të llogaritet në hollësi, por gjithçka më pak se rreth 50 për qind do të thotë se pas vitit 2030, përpjekjet do të duhet të përshpejtohen edhe më tej për të arritur në 100 për qind deri në vitin 2050. Kjo varet nga norma e konsumit: sa më shumë energji që kursehet, aq më e lehtë është të rritet përqindja e burimeve të ripërtëritshme. Përkundrazi, nëse konsumi rritet më tej, arritja e një përqindjeje më të lartë bëhet përkatësisht më e vështirë.

Sido që të jetë, duke pasur parasysh rolin madhor që luan sektori i energjisë elektrike i Kosovës në shkarkimet e gazrave me efekt serrë, si dhe performancën e dobët të sektorit për të kontribuar në cakun e burimeve të ripërtëritshme për vitin 2020,⁸⁴ aftësia e Kosovës për të arritur caqet e burimeve të ripërtëritshme dhe të shkarkimeve të gazrave me efekt serrë varet drejtpërdrejt nga aftësia e saj për të rritur energjinë e ripërtëritshme dhe për të filluar heqjen graduale të karburanteve fosile, ndërkohë që rritja e efijencës së energjisë do ta bëjë më të lehtë arritjen e këtyre caqeve.

⁸⁴ Progresi më i madh ishte falë rishikimit të të dhënave të biomasës, jo falë investimeve të reja aktuale. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Kosovo Annual Implementation Report 1 nëntor 2021](#).

Heqja graduale e të gjitha lëndëve djegëse fosile dhe veprimet e përkohshme ndaj ndotjes nga termocentralet me thëngjill

Pyetja e vetme më e rëndësishme për trajektoren e sektorit energjetik të Kosovës deri në vitin 2030 është kur do të mbyllen tri blloqet operative të Termocentralit Kosova A dhe dy blloqet e Kosova B,⁸⁵ sepse ato përbënin 95 për qind të gjenerimit të brendshëm të energjisë elektrike në vitin 2020.⁸⁶

Blloqet e Kosova A kanë midis 47 dhe 52 vjet që janë në përdorim, dhe ato të Kosova B kanë 38 dhe 39 vjet që janë në përdorim,⁸⁷ kështu që është e paqartë se për sa kohë do të jenë në gjendje të operojnë, pasi historikisht jetëgjatësia e termocentraleve me thëngjill në nivelin global është mesatarisht 46 vjet.⁸⁸

Anulimi i projektit të termocentralit me thëngjill Kosova e Re në vitin 2020 më në fund i ka hapur rrugë Kosovës që të flasë më realisht për t'i dhënë fund thëngjillit, mirëpo ndërprerjet e prodhimit në Kosova A dhe Kosova B në dhjetor 2021,⁸⁹ tregojnë se kjo mund të ndodhë shumë më shpejt se sa e pret dikush.

Për më tepër, BE-ja planifikon të prezantojë të ashtuquajturin Mekanizëm të Rregullimit të Kufirit të Karbonit⁹⁰ në vitet e ardhshme – afati i saktë kohor është ende duke u diskutuar, por mund të jetë që në vitin 2025. Ndër të tjera, kjo do të thotë se energjia elektrike e prodhuar nga lëndët djegëse fosile e importuar në BE do t'i nënshtrohet një tarife, duke e bërë kështu atë më pak tërheqëse për t'u blerë. Kjo mund të mos e godasë Kosovën aq fort sa për shembull Bosnjën dhe Hercegovinën, pasi Kosova nuk është një eksportues në shkallë të gjerë i energjisë elektrike, por ende do të ketë ndikime në tregtimin e energjisë elektrike të Kosovës me vendet fqinje dhe ato të BE-së.




Figura 1: Gjenerimi i energjisë elektrike në Kosovë, 2010/2020
Burimi: IEA Statistics

⁸⁵ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

⁸⁶ International Energy Agency, Kosovo, Electricity, 2020, qasur më 5 prill 2022.

⁸⁷ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

⁸⁸ Global Energy Monitor, Global Coal Plant Tracker, Korrik 2018, cituar në Ryna Yiyun Cui et al., Quantifying operational lifetimes for coal power plants under the Paris goals, Nature Communications 10(1):4759, Tetor 2019.

⁸⁹ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

⁹⁰ CEE Bankwatch Network, The EU carbon border adjustment mechanism: How to make it work for decarbonisation in the Western Balkans, 4 shkurt 2022.

Vendet që aplikojnë skemat e veta të çmimeve të karbonit mund të lirohen nga Mekanizmi, ndaj Komuniteti i Energjisë po inkurajon kompanitë e Ballkanit Perëndimor ta bëjnë këtë. Në nëntor 2021, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë miratoi një Udhërrëfyes të Dekarbonizimit,⁹¹ duke përcaktuar afatet kohore indikative për futjen e çmimit të karbonit. Aplikimi i çmimit të brendshëm të karbonit do të kishte avantazhin që të hyrat do të shkonin në buxhetin e Kosovës dhe jo në buxhetin e BE-së, kështu që ato do të mund të përdoreshin për investime në dekarbonizim.

Rekomandime: Në PKEK, të caktohen data të qarta dhe reale për mbylljen e Kosova A dhe B, ose të paktën opsionet për datat e mbylljes.

Të futet çmimi i karbonit sa më shpejt të jetë e mundur dhe më së voni deri në vitin 2025. Çmimi i karbonit do të duhej të arrijë nivelin e Skemës së BE-së për Tregtimin e Shkarkimeve më së voni deri në vitin 2030, në mënyrë që të shmanget Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Të përdoren të ardhurat për dekarbonizim dhe jo për buxhetin e shtetit në përgjithësi.

Pasi të caktohen datat e mbylljes, është thelbësore që të përshtaten planet e investimeve në përputhje me rrethanat dhe të sigurohet që reduktimi i ndotjes do të ndodhë, edhe nëse termocentralet do të mbyllen brenda pak vitesh. Kosova tashmë ka shkelur legjislacionin e Komunitetit të Energjisë për kontrollin e ndotjes që nga viti 2018 – fakt që po u kushton qytetarëve me jetë.⁹² Për blloqet ku vlerësohet e pamundur të investohet në pajisjet e kontrollit të ndotjes sepse ato do të mbyllen së shpejti, centralet duhet të reduktojnë orët e tyre të operimit për të mbajtur në nivel të ulët ndotjen e përgjithshme.

Rekomandim: Të integrohen në PKEK plane të qarta për investime dhe/ose reduktime të operimit për të zvogëluar ndikimet shëndetësore të termocentraleve të thëngjillit për pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së tyre.

Në veçanti, të përshpejtohet instalimi i kontrollit të pluhurit dhe NOx në Kosova B.⁹³

⁹¹ Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, [General Policy Guidelines Q1/2021/MC-EnC Decarbonisation Roadmap for the Contracting Parties of the Energy Community, Nëntor 2021](#).

⁹² CEE Bankwatch Network, [Comply or Close, Shtator 2021](#).

⁹³ [Kosovoprojects.eu, Dust and NOx reduction measures at TPP Kosovo B, Units B1 and B2, qasur 4 maj 2022](#).

Nevoja për tranzicion të drejtë

Deri më tani, koncepti i tranzicionit të drejtë duket se është përmendur kryesisht nga OJQ-të dhe shikuar realisht nuk ka zënë rrënjë në Kosovë. Megjithatë, kjo nuk mund të presë shumë më gjatë. Fakti që kundërshtimi i vërtetë ndaj tranzicionit energjetik nuk ka filluar ende mund të jetë thjesht sepse punëtorët e sektorit të thëngjillit nuk besojnë ende se kjo po ndodh. Kjo do të thotë se është pikërisht koha për të nisur bisedën, përpara se çështja të acarohet. Ndonëse mund të jenë OJQ-të ato që fillimisht u bëjnë presion autoriteteve përkatëse për të filluar vetëm planifikimin e tranzicionit, në fund të fundit pronësia duhet të merret në nivel lokal nga autoritetet vendore dhe komuniteti.

Është thelbësore që tranzicioni të mos shihet vetëm si një ushtrim i inxhinierisë ekonomike i planifikuar nga qendra. Ajo që nevojitet është një bisedë me personat e prekur dhe qytetarët e tjerë lidhur me nevojat, dëshirat dhe idetë e tyre. Për këtë arsye, përfshirja e lehtësuesve me përvojë në këtë proces është thelbësore.

Financimi do të jetë gjithashtu vendimtar. Brenda BE-së është krijuar një Fond për Tranzicion të Drejtë, por ky nuk është ende rasti në Ballkanin Perëndimor. Duke demonstruar planet e saj dhe nevojat konkrete për financim, Kosova mund të arsyetojë krijimin e një fondi të tillë.

Rekomandim: Të zhvillohet një plan me pjesëmarrjen e publikut për të mbyllur gradualisht minierat e linjtit në Kosovë dhe për të siguruar një tranzicion të drejtë social të rajoneve të prekura, duke ndjekur Tetë Hapat për një Tranzicion të Drejtë në Ballkanin Perëndimor.⁹⁴ Të sigurohet që kjo bëhet në konsultim të plotë me komunitetet e prekura nga individë me përvojë në lehtësimin e diskutimeve të tilla.

Të shfrytëzohen mundësitë e ofruara nga Iniciativa e Platformës në Mbështetje të Rajoneve të Thëngjillit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë, të tilla si vizitat e shkëmbimit dhe ndarja e përvojave.

Të sigurohet që PKEK-ja ofron një zbërthim të kostove të mundshme për ri-zhvillimin e zonave të minierave të thëngjillit dhe burime të mundshme të financimit.

⁹⁴ CEE Bankwatch Network, [Eight steps for a just transition in the Western Balkans, Prill 2021](#).

Dekarbonizimi në sektorin e energjisë elektrike, duke përfshirë prodhuesit për vetë-konsum (prosumatorët)

Sektori i energjisë së ripërtëritshme ka marrë më shumë vëmendje vitet e fundit, si për arsye pozitive ashtu edhe për ato negative. Nga njëra anë, përkundër mungesës relative të burimeve ujore në Kosovë, ajo ka vuajtur nga të njëjtat polemika mbi hidrocentralet e vogla si fqinjët e saj në vitet e fundit,⁹⁵ dhe energjia solare është rritur shumë ngadalë, duke arritur vetëm 10 MW deri në fund të vitit 2021.⁹⁶ Por kapaciteti i ri i erës ka hyrë në funksion së fundi, në fermën e erës me kapacitet 105 MW në Bajgorë.⁹⁷ Ekzistojnë gjithashtu më shumë plane për burime solare,⁹⁸ dhe vendi ka një prodhues të paneleve solare të aftë për të prodhuar 200 MW në vit.⁹⁹

Me vullnet të fortë politik për të rritur pjesën e energjisë së ripërtëritshme, një nga hapat kryesorë që tani duhet të ndërmerret është vendosja e sistemit të ri të stimujve nëpërmjet ligjit të ri për energjinë e ripërtëritshme, si dhe vazhdimi i lëvizjeve për të krijuar një treg funksional. Asnjëra nga këto nuk duhet të presë PKEK-në, por ajo që duhet të bëjë PKEK-ja është të identifikojë potencialin për energji të ripërtëritshme deri në vitin 2030, të ndërmarrë një ekzaminim të kufizimeve mjedisore dhe hapësinore dhe të identifikojë plane alternative në rast se skenari kryesor nuk funksionon.

Për shembull, planet e Kosovës për të përmbushur caqet e vitit 2020 mbështeteshin shumë në hidrocentralet e vogla dhe në ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit me kapacitet 250 MW. Megjithatë, pas disa kohësh u bë e qartë se planet fillestare për hidrocentralet e Zhurit nuk kishin gjasa të realizoheshin.¹⁰⁰ Në vitin 2018, Kosova përditësoi Planin Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme për të hequr centralet e Zhurit dhe për të rritur pak ambiciet e saj për burimet e erës në 173.8 MW,¹⁰¹ por kjo ishte tepër vonë për të ndikuar seriozisht në planet për vitin 2020.

Tani Zyra e Rregullatorit është duke shqyrtuar sërish një aplikacion për ndërtimin e një hidrocentrali me kapacitet 250 MW – këtë herë nga Eurokos, për hidrocentralin reversibil (me pompa për akumulim të ujit) “Drini”.¹⁰² Nuk është e qartë nëse kjo do të jetë pjesë e PKEK-së, por nëse është, do të duhet të ketë një plan rezervë në rast se nuk ndërtohet.

Një aspekt të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë janë prosumatorët që janë prodhues dhe konsumatorë të energjisë elektrike dhe të cilët ngarkojnë tepërcat e tyre në rrjet. Çdo konsumator i energjisë elektrike i lidhur në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët me një kapacitet të instaluar jo më të lartë se 100 kW mund të aplikojë te furnizuesi i tij për të marrë statusin e vetë-konsumatorit duke përdorur një skemë faturimi neto. Kjo ka bërë që 56 vetë-konsumatorë në Kosovë të kyçen që nga qershori 2021.¹⁰³ Kosova ka arritur kështu numrin më të lartë të vetë-konsumatorëve në Ballkanin Perëndimor.¹⁰⁴ Deri në fund të vitit 2021, mbi 100 vetë-konsumatorë ishin miratuar nga Zyra e Rregullatorit.¹⁰⁵

⁹⁵ Për shembull, shih Fatos Bytyçi, [Divided Kosovo mountain village unites to fight hydropower plant](#), Reuters, 11 tetor 2019 dhe raportimin rreth kësaj teme në Prishtina Insight, qasur për herë të fundit më 1 prill 2021.

⁹⁶ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

⁹⁷ Qeveria e Kosovës, [Inaugurohet parku energjetik në Selac dhe Baigorë](#), 11 mars 2022.

⁹⁸ Igor Todorović, [Solar Energy Group to build 150 MW photovoltaic plant in Kosovo](#), Balkan Green Energy News, 1 mars 2021.

⁹⁹ [Uebfaqja i Jaha Solar](#), qasur më 5 prill 2022.

¹⁰⁰ Mott MacDonald/IPF3, [Regional strategy for sustainable hydropower in the Western Balkans Background report no. 7: Inventory of planned hydropower plant projects](#), Drafti Final 3, Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor, Nëntor 2017.

¹⁰¹ Qeveria e Kosovës, [Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë i Republikës së Kosovës 2011-2020, Përditësimi për 2018-2020](#), tetor 2018. (Në dokument shkruan Maj 2020, por nga burime të tjera është e qartë se është adoptuar në tetor 2018).

¹⁰² Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raporti Vjetor 2021, Mars 2022](#).

¹⁰³ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Secretariats WB6 Energy Transition Tracker, Qershor 2021](#).

¹⁰⁴ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Secretariats WB6 Energy Transition Tracker, Qershor 2021](#).

¹⁰⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji, [Raportet Vjetore 2018-2021](#).

USAID-i ka vlerësuar se konsumatorët shtëpiakë dhe bizneset kosovare do të mund të instalojnë 250 MW energji solare për vetë-konsum deri në vitin 2030, qoftë si prosumatorë ose si prodhues për të gjitha apo një pjesë të nevojave të tyre. Këto mund të rrisin për gati një të tretën të gjithë energjinë solare të instaluar deri atëherë.¹⁰⁶ Përveç një kontributi të rëndësishëm në furnizimin me energji elektrike, mbështetja e zhvillimit të prosumatorëve është një mënyrë e rëndësishme për të siguruar mbështetjen e publikut për tranzicionin energjetik, pasi ata mund të përfitojnë drejtpërdrejt prej tij.

Rekomandim: Në sektorin e energjisë, të përqendrohet kryesisht në zhvillimin e energjisë solare dhe të erës deri në vitin 2030, duke vlerësuar me kujdes potencialin për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme në lokacione me qëndrueshmëri mjedisore. Puna e ndërmarrë tashmë nga The Nature Conservancy në Qarkun e Zarës në Kroaci, mund të jetë e dobishme për këtë.¹⁰⁷ Përdorimi i lokacioneve ish-industriale (brownfield sites) do të duhej të jetë prioriteti më i lartë.

Të shmangët mbështetja e tepërt në projekte të mëdha specifike, siç është hidrocentrali reversibil “Drini”, dhe të vlerësohen me kujdes gjasat reale për të vazhduar tutje. Të zhvillohen plane rezervë në rast se këto projekte nuk materializohen.

Të ndërmerren hapa të mëtejshëm për të mbështetur prosumatorët në mënyrë që të maksimizojnë potencialin e tyre, duke përfshirë nëpërmjet thjeshtimit të procedurave dhe uljes së tatimeve, duke marrë parasysh rekomandimet nga studimi i porositur nga USAID-i mbi këtë temë.¹⁰⁸

Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes – ngrohja qendrore

Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes shkon krah për krah me eficientësinë e energjisë dhe ne kemi dhënë rekomandime më lart në lidhje me konsumatorët shtëpiakë. Megjithatë, ngrohja qendrore meriton një ekzaminim specifik pasi mund të përfaqësojë qoftë një mundësi për dekarbonizim, ose një pengesë serioze. Në përgjithësi, synimi do të duhej të jetë elektrifikimi i sektorit të ngrohjes aty ku është e mundur, si dhe përdorimi i burimeve gjeotermike aty ku është e përshtatshme.

Prishtina, Gjakova, Mitrovica dhe Zveçani kanë sistem të ngrohjes qendrore, por këto mbulojnë vetëm rreth 3-5 për qind të kërkesës për ngrohje.¹⁰⁹ Në Prishtinë, ngrohja punonte me mazut deri në fillimin e kogjenerimit në Bllokun B1 të Termocentralit Kosova B, ndërsa një ngrohje e re në Gjakovë që punon me biomasë (mbeturina të materialit drusor dhe nga krasitjet e hardhive) filloi të operojë në tetor 2021 dhe gjithashtu zëvendësoi përdorimin e mazutit.¹¹⁰ Në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan sistemet me sa duket nuk janë më funksionale.¹¹¹ Ndrohja e Gjakovës duket se funksionon me burime të qëndrueshme, por do të nevojitet monitorim i afërt për t'u siguruar që ajo të mbetet brenda vlerave kufitare të ndotjes së ajrit dhe të mos përdorë biomasë parësore pyjore por vetëm mbeturina drusore.

¹⁰⁶ Vladimir Spasić, –Kosovo could add 900 MW of solar by 2030, 250 MW for self-consumption USAID, 27 korrik 2021.

¹⁰⁷ Mark Lambides and Igor Vejinovic, Smarter Energy Siting Helps Achieve Climate & Biodiversity Goals, 9 prill 2021.

¹⁰⁸ DT Global, Kosovo Security of Supply, JO 27, Assessment of PV generators in Kosovo, Summary report, Annex 3, Janar 2021.

¹⁰⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2021, Mars 2022.

¹¹⁰ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Sekretariatit welcomes new biomass-based cogeneration plant in Gjakova, Kosova, 25 tetor 2021.

¹¹¹ Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor, EU Allocates Additional Grant to introduce District Heating in Eight Municipalities in Kosovo, 12 nëntor 2021.

Megjithatë, një projekt i financuar nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor është aktualisht në proces e sipër për të vlerësuar fizibilitetin e sistemeve të reja në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, Drenas, Obiliq dhe Zveçan, dhe një përmirësim të sistemit ekzistues në Mitrovicë.¹¹² Në shumicën e rasteve nuk është e qartë se çfarë burimesh energjie do të përdornin këto.

Gjithashtu janë duke u zhvilluar plane për të shtuar 70 MW kapacitet solar termik në sistemin e ngrohjes qendrore të Prishtinës, financuar nga KfW e Gjermanisë dhe mbase edhe BERZH.¹¹³ Kolektorët solarë do të përdoren për të ngrohur ujin në një rezervuar nëntokësor me një kapacitet prej 410,000 metra kub dhe kjo do të duhej të ishte e mjaftueshme për të ngrohur 12,000 ekonomi familjare.¹¹⁴

Rekomandime: T'i jepet prioritet projektit solar termik në Prishtinë për të ulur varësinë nga Kosova B për ngrohje qendrore.

Të informohet dhe të konsultohet më tej publiku lidhur me opsionet që po shqyrtohen për sistemet e reja të ngrohjes qendrore në Kosovë dhe kostot dhe përfitimet e tyre. T'i jepet prioritet ngrohjes qendrore solare-termike dhe, aty ku është e përshtatshme, gjeo-termike. Të përdoret biomasa vetëm aty ku është e sigurt se do të ketë në dispozicion mbeturina të mjaftueshme drusore, në mënyrë që të shmanget shpyllëzimi i mëtejshëm, shkarkimet e gazrave me efekt serra dhe ndotja e ajrit si dhe të mos planifikohen impiante të biomasës duke përdorur biomasë parësore pyjore.

Në asnjë rrethanë të mos ndërtohen impiante ngrohjeje me gaz fosil ose impiante që shndërrojnë mbeturinat në energji duke përdorur mbeturinat komunale, pasi ato pengojnë riciklimin dhe masat parandaluese të mbeturinave, rrisin ndotjen e ajrit dhe krijojnë mbetje të rrezikshme të hirit dhe filtrave.¹¹⁵

¹¹² Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor, [EU Allocates Additional Grant to introduce District Heating in Eight Municipalities in Kosovo, 12 nëntor 2021](#).

¹¹³ Igor Todorović, [Prishtinas district heating company to build 70 MW solar thermal plant, Balkan Green Energy News, 26 mars 2022](#).

¹¹⁴ Igor Todorović, [Prishtinas district heating company to build 70 MW solar thermal plant, Balkan Green Energy News, 26 mars 2022](#).

¹¹⁵ Shih për shembull, CEE Bankwatch Network, [New analysis: Belgrade incinerator public-private partnership a textbook case of corporate capture, Dhjetor 2019](#)

Dekarbonizimi në transport

Elektrifikimi i transportit do të duhej të jetë mënyra kryesore për të arritur dekarbonizimin, siç u tha më lart, sepse deri tani biokarburantet paraqesin probleme të pakapërcyeshme të paqëndrueshmërisë, ndërsa hidrogjeni është ende shumë i shtrenjtë dhe pothuajse në tërësi përftohet duke përdorur lëndë djegëse fosile

Megjithatë, kjo nuk duhet të nënkuptojë thjesht promovim të makinave elektrike. Të dhënat aktuale për transportin në Kosovë janë të pakta,¹¹⁶ por transporti rrugor privat mbizotëron si për transportin e udhëtarëve ashtu edhe për transportin e mallrave. Kjo është joeficiente për nga aspekti energjetik dhe krijon mbingarkesë dhe ndotje të panevojshme, prandaj, në PKEK-në e Kosovës do të duhej t'i kushtohet vëmendje më e madhe zhvillimit të transportit publik – si urban ashtu edhe ndërrurban – dhe transportit të pa-motorizuar, si ecja, çiklizmi dhe e-mobiliteti. Kjo është një nga pikat e dobëta të PKEK-së së Shqipërisë dhe Kosova do të duhej të nxjerrë mësim për t'i kushtuar më shumë vëmendje kësaj çështjeje.¹¹⁷

Transporti publik urban dhe transporti i pa-motorizuar mund të jenë të vështira për t'u promovuar nëpërmjet politikave kombëtare siç është PKEK-ja për shkak të nevojës për planifikim të përshtatshëm hapësinor lokal. Prandaj, PKEK-ja do të duhej të sigurojë që ndahen burime të mjaftueshme jo vetëm për pajisje të tilla si autobusët elektrikë ose tramvajet, por edhe për rinovimin urban që është i nevojshëm për ta bërë më të lehtë për qytetarët të ecin dhe të përdorin biçikletat në qytetet më të mëdha.

Rekomandime: Të përqendrohet në elektrifikimin e transportit dhe të shmangen shpërqendrimet si gazi, biokarburantet ose hidrogjeni. Hidrogjeni mund të bëhet i rëndësishëm më vonë, por nuk do të duhej të jetë një prioritet i menjëhershëm.

Të sigurohet infrastruktura për automjetet elektrike, por fondet publike nuk do të duhej të subvencionojnë blerjen e makinave elektrike individuale pasi tendenca është që nga kjo të përfitojnë ata që qëndrojnë mirë materialisht.

Paraja publike do të duhej të investohet në transportin publik të elektrifikuar, duke përfshirë trenat, autobusët dhe mbase tramvajet, dhe në transformimin e qyteteve për të mirën e transportit të pa-motorizuar.

¹¹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës ofron disa të dhëna, por nuk identifikon pjesët modale.

¹¹⁷ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Energy Community and National Energy and Climate Plans, qasur më 5 prill 2022.](#)

Kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria

Sipas të gjitha gjasave, nuk është me kosto efektive për Kosovën që të investojë miliona në kërkime parësore për teknologji të reja, por vendi duhet të gjejë mënyra për ta vënë tranzicionin e energjisë në funksion të vendit, duke përdorur aftësitë që qytetarët e vendit tashmë i kanë dhe duke zhvilluar aftësi të reja. Hapja e fabrikës Jaha Solar është një shembull i mirë për të siguruar që disa nga fitimet nga tranzicioni të qëndrojnë brenda vendit.

Tranzicioni kërkon sigurisht një shkallë të lartë digjitalizimi në sektorin e energjisë, duke ofruar mundësi për zhvillimin e TIK-ut në vend. Nevojiten aftësi të reja për auditorët e trajnuar të efikasitetit të energjisë dhe ekspertët e efikasitetit të energjisë në autoritetet kombëtare dhe lokale. Punëtorët e ndërtimit duhet të trajnohen për të kryer rinovime ndërtesash me cilësi të mirë dhe për të ndërtuar ndërtesa shumë efikente. Nevojitet gjithashtu trajnim për aftësitë e instalimit të paneleve solare dhe pompave termike

Rekomandime: Të sigurohet që sistemi arsimor i Kosovës dhe mundësitë e trajnimit profesional janë të harmonizuara me tranzicionin energjetik dhe të përfshihen ndarjet e duhura buxhetore për trajnime të tilla. Kjo mund të lidhet vetëm me planifikimin e tranzicionit, por do të duhej të shkojë përtej kësaj për të angazhuar ndërmarrësit, të rinjtë dhe diasporën.

Konkluzione dhe rekomandime

Shumë nga elementet përbërëse për suksesin e tranzicionit energjetik të Kosovës shkojnë përtej sektorëve të energjisë dhe transportit dhe janë më tepër të lidhura me funksionimin e shoqërisë në tërësi. Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje nuk ka qenë një pikë e fortë në Ballkanin Perëndimor, por çdo ekonomi familjare ndikohet nga sektori i energjisë në mënyra të ndryshme dhe secili duhet të ketë të drejtë të thotë fjalën e tij.

Çdo ekonomi familjare konsumon energji dhe shumë prej tyre janë të prekur nga ndotja ose dëmtime të tjera mjedisore të shkaktuara nga sektori. Ata që do të humbasin drejtpërdrejt vendin e punës si pasojë e ndryshimeve në sektor do të goditen rëndë, ndërsa nga ana tjetër ka mundësi që njerëzit e zakonshëm të prodhojnë energji elektrike në shtëpitë e tyre dhe të jetojnë më rehat si rezultat i izolimit më të mirë.

Kjo do të thotë se nevojitet një rritje e dialogut publik për tranzicionin energjetik dhe PKEK-ja duhet t'i nënshtrohet konsultimeve të gjera. Kjo do të përfshijë procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili është një kërkesë ligjore, por nuk do të duhej të kufizohet në këtë kanal.

Rekomandimet tona konkrete për PKEK-në e Kosovës, të paraqitura në tekstin e mësipërm, janë përsëritur këtu. Ato përqendrohen kryesisht në lëvizjen e Kosovës drejt një ekonomie kompatible me BE-në, me efikasitet të energjisë dhe me burime të ripërtëritshme në shkallë 100 për qind, të bazuar në integrimin e ngushtë të tregut, gjenerimin fleksibël të energjisë elektrike dhe elektrifikimin e sektorëve të transportit dhe ngrohjes.

Sidoqoftë, jo çdo politikë e BE-së për energjinë rezulton më e mira, pasi shumë vende të varura nga gazi e kanë kuptuar çfarë kosto ka kjo politikë e tyre gjatë dimrit dhe pranverës së fundit për shkak të çmimeve shumë të larta dhe invazionit rus të Ukrainës. Një nga sfidat për Kosovën do të jetë të kuptojë se cilat politika kompatible me BE-në ia vlen vërtet të ndiqen dhe cilat më vonë

vonë mund të rezultojnë të jenë kundërproduktive. Ky është aspekti ku ne shpresojmë se përvoja jonë e përmbledhur në këtë punim do të jetë e vlefshme. E ardhmja energjetike e Kosovës qëndron në tregun energjetik të BE-së, por ajo nuk duhet të ndjekë verbërisht çdo ide nga politika e BE-së për energjinë. Përkundrazi, Kosova duhet të gjejë rrugën e vet për të siguruar që tranzicioni energjetik do të shërbejë për të mirën e vendit.

Siguria e energjisë, solidariteti dhe besimi

Kosova këshillohet:

1. Të çimentojë në PKEK-në e saj vendimin për të mos zbatuar projektin e gazsjellësit nga Maqedonia e Veriut¹⁸ dhe të shmangë plotësisht varësinë nga gazi. Në vend të kësaj, ajo do të duhej të bëjë një kërcim drejt elektrifikimit të bazuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë brenda vendit.
2. Të ndjekë elektrifikimin e transportit si dhe përmirësimin e transportit publik, për të ndihmuar në uljen e kërkesës nga automjetet individuale dhe për të reduktuar varësinë nga nafta. Nuk rekomandohet të ndiqen biokarburantet si një alternativë ndaj produkteve të naftës për transport.
3. Së pari, të përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme dhe elektrifikimin e ngrohjes dhe transportit, dhe vetëm më pas të shqyrtojë rolin e mundshëm të hidrogjenit për sektorët e vështirë për t'u dekarbonizuar, pasi të jetë bërë më i qartë në BE roli i hidrogjenit dhe pasi të jenë ulur kostot e hidrogjenit të ripërtëritshëm.
4. Të hiqet gradualisht përdorimi i thëngjillit sa më shpejt që të jetë e mundur teknikisht për ta bërë këtë, duke filluar me termocentralin Kosova A i cili duhet të mbyllet urgjentisht.

Tregu plotësisht i integruar i energjisë

5. Kosova dhe Shqipëria kanë bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e një tregu të përbashkët të energjisë elektrike dhe do të duhej të vazhdojnë punën në këtë drejtim, si një parakusht i rëndësishëm për arritjen e një përqindjeje të madhe të energjisë së ripërtëritshme të ndryshueshme.

Efiçienca e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës

Kosova këshillohet:

6. Të vendosë caqe më ambicioze për të përshpejtuar punën e KEDS-it për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes për të reduktuar humbjet teknike dhe të përkufizojë strukturën dhe burimet e mundshme të financimit.

¹⁸ Igor Todorović, [Kosovashelves US-backed gas pipeline project, Balkan Green Energy News, 5 tetor 2021.](#)

7. Të vendosë caqe ambicioze për futjen e shpejtë në përdorim të njehsorëve inteligjentë. Përvoja e Malit të Zi me projektin e njehsorëve inteligjentë të financuar nga BERZH mund të jetë e dobishme.¹¹⁹
8. Të vazhdohet me adoptimin e strategjisë së rinovimit të ndërtesave edhe para adoptimit të PKEK-së.
9. Të identifikohen barrierat aktuale për përdorimin e pompave termike në ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla dhe të përcaktohen masat për kapërcimin e tyre në PKEK, duke përfshirë stimujt tatimorë.
10. Të sigurohet që Fondi i Eficiencës së Energjisë ka burime të mjaftueshme për të financuar rinovimet e thella dhe instalimin e pompave termike dhe kapaciteteve solare si burim termik në sektorin e banimit. Financimi me grante duhet të marrë parasysh rezultatet dhe rekomandimet e studimit të porositur për projektin SEEK.¹²⁰
11. Të zhvillohen aktivitete të edukimit publik mbi nevojën për të tharë siç duhet drurin përpara përdorimit.
12. Të sigurohet që komunat janë mjaftueshëm të fuqizuara, të trajnuara dhe kanë burime për të çuar përpara masat e eficiencës së energjisë në ekonomitë familjare.
13. Të hartohet dhe të adoptohet një plan formal për të trajtuar varfërinë energjetike, bazuar në një qasje pjesëmarrëse ndaj përcaktimit të nevojave të qytetarëve. Kjo do të duhej të përfshijë sa vijon:
 - auditime të eficiencës së energjisë dhe këshilla për ekonomitë familjare për masat që mund të merren pa asistencë profesionale (izolim nga rrymat e ajrit, ndriçim LED, etj.)
 - duke shkuar përtej mbështetjes së të ardhurave për të përfshirë përmirësime të eficiencës së energjisë për familjet e cenueshme, përfshirë izolimin, ngrohjen më eficiente (mundësisht pompa termike, ose potencialisht ngrohje me dru, aty ku është më e përshtatshme) dhe instalimin e paneleve solare për ngrohje të ujit dhe/ose teknologjisë solare fotovoltaike për të reduktuar kostot.¹²¹

¹¹⁹ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, [EPCG Metering and Distribution Project, 22 dhjetor 2021](#).

¹²⁰ GFA Consulting Group & HPC International, [Residential Buildings Efficiency Retrofits Baseline Study \(Final Draft\), Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë \(SEEK\), Mars 2020 dhe GFA Consulting Group & HPC International, Market Study \(Final Draft\), Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë \(SEEK\), Prill 2020](#).

¹²¹ Më shumë hollësi jepen nga Energy Institute Hrvoje Požarand DOOR, [Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Dhjetor 2021](#).

Dekarbonizimi i ekonomisë

Kosova këshillohet:

14. Të llogarisë cakun e vet për reduktimin e shkarkimeve të gazrave me efekt serrë dhe caqet e efikasitetit të energjisë në një mënyrë që nuk vonon veprimet e rëndësishme për arritjen e dekarbonizimit deri pas vitit 2030, veçanërisht pasi shumë nga opsionet më të lehta për veprim janë në dispozicion tashmë në këtë dekadë.
15. Të vendosë një cak për energjinë e ripërtëritshme për vitin 2030 që është kompatibel me arritjen e 100 për qind të burimeve të ripërtëritshme deri në vitin 2050. Kjo duhet të llogaritet në hollësi, por gjithçka më pak se rreth 50 për qind do të thotë se pas vitit 2030, përpjekjet do të duhet të përshpejtohen edhe më tej për të arritur në 100 për qind deri në vitin 2050. Kjo varet nga norma e konsumit: sa më shumë energji që kursehet, aq më e lehtë është të rritet përqindja e burimeve të ripërtëritshme. Përkundrazi, nëse konsumi rritet më tej, arritja e një përqindjeje më të lartë bëhet përkatësisht më e vështirë.
16. Në PKEK, të caktohen data të qarta dhe reale për mbylljen e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, ose të paktën opsionet për datat e mbylljes.
17. Të futet çmimi i karbonit sa më shpejt të jetë e mundur dhe më së voni deri në vitin 2025. Çmimi i karbonit do të duhet të arrijë nivelin e Skemës së BE-së për Tregtimin e Shkarkimeve më së voni deri në vitin 2030, në mënyrë që të shmanget Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Të përdoren të ardhurat për dekarbonizim dhe jo për buxhetin e shtetit në përgjithësi.
18. Të integrohen në PKEK plane të qarta të investimeve për kontrollin e ndotjes dhe/ose reduktimeve të operimit për të zvogëluar ndikimet shëndetësore të termocentraleve të thëngjillit për pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së tyre.
19. Të zhvillohet një plan me pjesëmarrjen e publikut për të mbyllur gradualisht minierat e linjitet në Kosovë dhe për të siguruar një tranzicion të drejtë social të rajoneve të prekura, duke ndjekur Tetë Hapat për një Tranzicion të Drejtë në Ballkanin Perëndimor.¹²² Të sigurohet që kjo bëhet në konsultim të plotë me komunitetet e prekura nga individë me përvojë në lehtësimin e diskutimeve të tilla.
20. Të shfrytëzohen mundësitë e ofruara nga Iniciativa e Platformës në Mbështetje të Rajoneve të Thëngjillit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë, të tilla si vizitat e shkëmbimit dhe ndarja e përvojave.
21. Të sigurohet që PKEK-ja ofron një zbrëthim të kostove të mundshme për ri-zhvillimin e zonave të minierave të thëngjillit dhe burime të mundshme të financimit.

¹²² CEE Bankwatch Network, [Eight steps for a just transition in the Western Balkans, Prill 2021](#).

22. Në sektorin e energjisë, të përqendrohet kryesisht në zhvillimin e energjisë solare dhe të erës deri në vitin 2030, duke vlerësuar me kujdes potencialin për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme në lokacione me qëndrueshmëri mjedisore. Puna e ndërmarrë tashmë nga The Nature Conservancy në Qarkun e Zarës në Kroaci, mund të jetë e dobishme për këtë.¹²³ Përdorimi i lokacioneve ish-industriale (brownfield sites) do të duhej të jetë prioriteti më i lartë.
23. Të shmangët mbështetja e tepërt në projekte të mëdha specifike, siç është hidrocentrali reversibil “Drini”, dhe të vlerësohen me kujdes gjasat reale për të vazhduar tutje. Të zhvillohen plane rezervë në rast se këto projekte nuk materializohen.
24. Të ndërmerren hapa të mëtejme për të mbështetur prosumatorët në mënyrë që të maksimizojnë potencialin e tyre, duke përfshirë nëpërmjet thjeshtimit të procedurave dhe uljes së tatimeve, duke marrë parasysh rekomandimet nga studimi i porositur nga USAID-i mbi këtë temë.¹²⁴
25. T’i jepet prioritet projektit solar termik në Prishtinë për të ulur varësinë nga Kosova B për ngrohje qendrore
26. Të informohet dhe të konsultohet më tej publiku lidhur me opsionet që po shqyrtohen për sistemet e reja të ngrohjes qendrore në Kosovë dhe kostot dhe përfitimet e tyre.
27. T’i jepet prioritet ngrohjes qendrore solare-termike dhe, aty ku është e përshtatshme, gjeo-termike. Të përdoret biomasa vetëm aty ku është e sigurt se do të ketë në dispozicion mbeturina të mjaftueshme drusore, në mënyrë që të shmangët shpyllëzimi i mëtejshëm, shkarkimet e gazrave me efekt serrë dhe ndotja e ajrit dhe të mos planifikohen impiante të biomasës duke përdorur biomasë parësore pyjore.
28. Në asnjë rrethanë të mos ndërtohen impiante ngrohjeje me gaz fosil ose impiante që shndërrojnë mbeturinat në energji duke përdorur mbeturinat komunale, pasi ato pengojnë riciklimin dhe masat parandaluese të mbeturinave, rrisin ndotjen e ajrit dhe krijojnë mbetje të rrezikshme të hirit dhe filtrave.¹²⁵
29. Të përqendrohet në elektrifikimin e transportit dhe të shmangen shpërqendrimet si gazi, biokarburantet ose hidrogjeni. Hidrogjeni mund të bëhet i rëndësishëm më vonë, por nuk do të duhej të jetë një prioritet i menjëhershëm.
30. Të sigurohet infrastruktura për automjetet elektrike, por të mos përdoren fondet publike për të subvencionuar blerjen e makinave elektrike individuale pasi tendenca është që nga kjo të përfitojnë ata që qëndrojnë mirë materialisht.
31. Të investohet paraja publike në transportin publik të elektrifikuar, duke përfshirë trenat, autobusët dhe mbase tramvajet, dhe në transformimin e qyteteve për të mirën e transportit të pa-motorizuar.

Kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria

32. Të sigurohet që sistemi arsimor i Kosovës dhe mundësitë e trajnimit profesional janë të harmonizuara me tranzicionin energjetik dhe të përfshihen ndarjet e duhura buxhetore për trajnime të tilla. Kjo mund të lidhet vetëm me planifikimin e tranzicionit, por do të duhej të shkojë përtej kësaj për të angazhuar ndërmarrësit, të rinjtë dhe diasporën.

¹²³ Mark Lambides and Igor Vejinovic, [Smarter Energy Siting Helps Achieve Climate & Biodiversity Goals](#), 9 prill 2021.

¹²⁴ DT Global, [Kosovo Security of Supply, JO 27. Assessment of PV generators in Kosovo, Summary report, Annex 3, Janar 2021](#).

¹²⁵ Shih për shembull, CEE Bankwatch Network, [New analysis: Belgrade incinerator public-private partnership a textbook case of corporate capture](#), Dhjetor 2019.



Funded by
the European Union

“Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BIRN Kosova, CEE Bankwatch, ERA Group dhe TV Mreza dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”

